



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE FERIZAJ - DEGA E GJYKATËS KAÇANIK

---

Numri i lëndës: 2023:224179

Datë: 25.03.2024

Numri i dokumentit: 05499991

**2023:227673**

**GJYKATA THEMELORE FERIZAJ-DEGA KAÇANIK**- Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni Penal, gjyqtarja Zajrete Muhaxheri, me sekretaren juridike Indira Beqa , duke vendosur lidhur me aprovimin e marrëveshjes së ndërmjetësimit, Nd.nr.06/24 të datës 16.02.2024 e lidhur në zyrën e ndërmjetësimit të kësaj gjykate, në mes të pandehurit M.G nga fsh.... -Kaçanik , dhe përfaqësuesit së të dëmtuarës KEDS Sh.a Ferizaj, Q. S., sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore Ferizaj PP/II.nr.1411/23 të datës 25.10.2023, për shkak të veprës penale në vazhdim, Vjedhja e shërbimeve nga neni 314 par.1 lidhur me nenin 77 të KPRK-së, në bazë të nenit 15 të Ligjit për Ndërmjetësim nr. 06/L-009, më datën 22.03.2024, mori këtë:

**A K T V E N D I M**

**PRANOHET** marrëveshja e ndërmjetësimit Nd.nr.06/24 të datës 16.02.2024, e lidhur në Zyrën Ndërmjetësimit të kësaj gjykate, në mes të pandehurit M.G nga fsh....-Kaçanik , dhe përfaqësuesit së të dëmtuarës KEDS Sh.a Ferizaj, Q.S.

**HUDHET** aktakuza e Prokurorisë Themelore në Ferizaj, PP/II.nr.1411/23 e datës 25.10.2023, dhe **PUSHON** procedura penale ndaj të pandehurit M.G nga fsh....-Kaçanik, i lindur me datë ..., për shkak të veprës penale, Vjedhja e shërbimeve në vazhdim nga neni 314 par.1 lidhur me nenin 77 të KPRK-së.

**A r s y e t i m**

Prokuroria Themelore në Ferizaj me aktakuzën, PP/II.nr.1411/23 e datës 25.10.2023, e ka akuzuar të pandehurin M.G nga fsh....-Kaçanik, për shkak të veprës penale, Vjedhja e shërbimeve në vazhdim nga neni 314 par.1 lidhur me nenin 77 të KPRK-së.

Në shqyrtimin fillestar të datës 30.01.2024, palët në procedurë janë pajtuar që lënda penale e evidentuar si 2023:227673, të procedohet sipas procedurës së ndërmjetësimit.

Gjykata duke vepruar konform, nenit 8 par.3 të Ligjit për Ndërmjetësim vendosi që çështja të dërgohet në Zyrën e Ndërmjetësimit.

Me datën 16.02.2024, në Zyrën Ndërmjetësimit të kësaj gjykate, është arritur marrëveshja ndërmjetësimit, Nd.nr.06/24, në mes palëve në procedurë dhe atë të pandehurit M.G dhe përfaqësuesit të dëmtuarës KEDS Sh.a Ferizaj, Q.S.

Andaj, Gjykata duke vepruar konform dispozitave të nenit 15 par.1 të Ligjit për Ndërmjetësim e aprovoi këtë Marrëveshje, pasi që të njëjtën e vlerësoi që është lidhur me vullnetin e palëve në procedurë dhe në pajtim me ligjin në fuqi.

Nga sa u tha më lartë e konform nenit 15 par.1 të Ligjit për Ndërmjetësim nr. 06/L-009, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

## **GJYKATA THEMELORE FERIZAJ**

### **DEGA KAÇANIK**

**2023:227673 datë, 22.03.2024**

Sekretarja Juridike

Indira Beqa

Gjyqtarja,

Zajrete Muhaxheri

**KESHILLA JURIDIKE:** Kundër këtij aktvendimi, pala e pakënaqur mund të ushtrojë ankesë ne afat prej 3 ditësh nga dita e pranimit. Ankesa i drejtohet Gjykatës së Apelit në Prishtinë, përmes kësaj Gjykate.